URDHËR
Nr.309, datë 13.4.2011

PËR MIRATIMIN E FORMËS SË INFORMACIONEVE TREMUJORE, PËRFUNDIMTARE DHE PËRMBAJTJEN E PLANIT VJETOR TË PUNËS NGA ANA E ZOTËRUESVE TË LEJEVE MINERARE TË KËRKIMIT-ZBULIMIT PËR GRUPIN E MINERALEVE NDËRTIMORE

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 20, pika 3 dhe 56, pika 2 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Formati i informacionit tremujor për veprimtarinë minerare të realizuar nga zotëruesi i lejes minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore, duhet të jetë në përputhje me formatin e përshkruar në aneksin 1 të këtij urdhri. Ky informacion duhet të dorëzohet pranë institucionit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) jo më vonë se data 15 e muajit që vijon, për çdo tremujor. Mosrespektimi i kësaj kërkese ligjore dënohet me masën administrative gjobë prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh për çdo shkelje në përputhje me nenin 45 pika 1/ç të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë".

2. Subjektet minerare të pajisura me leje minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore, duhet që në përfundim të afatit të lejes, apo përfundimit të saj përpara këtij afati të përgatitin raportin përfundimtar për zhvillimin e veprimtarisë minerare, që duhet të jetë në përputhje me formatin e përshkruar në aneksin 2 të këtij urdhri, duke dhënë në mënyrë të detajuar investimet e realizuara gjatë kërkimit-zbulimit, punimet e kryera në zonën e tij të lejuar (shoqëruar me vizatimet inxhinierike) dhe rezultatet e të gjitha provave të marra, mosdorëzimi i këtij raporti përfundimtar dënohet me masën administrative gjobë 300 000 (treqind mijë) lekë në përputhje me nenin 45 pika 1/ë të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe në rastet kur mosparaqitja e këtij raporti kalon afatin e 3 (tre) muajve nga përfundimi i afatit të së drejtës minerare çon menjëherë (*ope legis*) në humbjen e së drejtës për t'u pajisur në të ardhmen me çfarëdo lloji lejeje minerare, për zonën e tij të lejuar të kërkim-zbulimit sipas përcaktimeve të nenit 20 pika 2 e këtij ligji.

3. Subjektet minerare të pajisura me leje minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore, duhet të realizojnë planin e mbylljes të veprimtarisë minerare dhe planin e rehabilitimit përfundimtar të zonës së tyre të lejuar, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë".

4. Institucioni i SHGJSH-së jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të çdo tremujori, duhet të dorëzojë në METE raportin përmbledhës për veprimtarinë minerare të subjekteve të pajisura me lejet minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore, që duhet të përmbajë të dhëna për:

i) realizimin e investimeve;

ii) vlerën e punimeve minerare të kërkim-zbulimit të realizuara;

iii) vlerën e operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare.

5. Institucioni i SHGJSH-së jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të çdo gjashtëmujori, duhet të dorëzojë në METE raportin përmbledhës për veprimtarinë minerare të subjekteve të pajisura me lejet minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore, që duhet të përmbajë të dhëna për:

i) respektimin e realizimit të projektit minerar nga subjektet minerare;

ii) realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare (nëse ka);

iii) vlerësimin e rezervave minerare të zbuluara;

iv) kryerjen e operacioneve minerare në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar.

6. Institucioni i SHGJSH-së jo më vonë se 60 ditë pas përfundimit të çdo viti duhet të dorëzojë në METE raportin përmbledhës për veprimtarinë minerare të subjekteve të pajisura me lejet minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore, që duhet të përmbajë të dhëna për:

i) realizimin e investimeve nga çdo subjekt minerar dhe në total;

ii) vlerën e punimeve minerare të kërkim-zbulimit të realizuara nga çdo subjekt minerar dhe në total;

iii) vlerën e operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare;

iv) respektimin e realizimit të projektit minerar për çdo subjekt minerar;

v) realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare për çdo subjekt minerar (nëse ka);

vi) vlerësimin e rezervave minerare të zbuluara nga çdo subjekt dhe në total;

vii) kryerjen e operacioneve minerare në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar.

7. Institucioni i SHGJSH-së propozon masat administrative në METE për çdo subjekt minerar, për çdo rast të mosrespektimit të pikave 1, 2 dhe 3 të këtij urdhri.

8. Institucioni i SHGJSH-së vlerëson raportin përfundimtar të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore dhe realizimin e planit të rehabilitimit të çdo subjekti minerar dhe i paraqet për miratim ministrit vlerësimin e tij në respekt të kërkesave të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.

9. Institucioni i SHGJSH-së vlerëson dhe miraton vlerat e garancive financiare vjetore për realizimin e programit minimal të punës dhe planit të rehabilitimit progresiv e përfundimtar të mjedisit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e paraqitjes së tyre. Tejkalimi i këtij afati i konsideron këto vlera të miratuara.

10. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet institucioni i SHGJSH-së dhe drejtoria përgjegjëse në METE që trajton problematikat e lejeve minerare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço